

Sistemi politik

Fuqia politike në Zvicër është e ndarë në tri rrafshe: federatë, kantone (shtete anëtare) dhe komuna. Zviceranet dhe zviceranët përmes votimeve mund të vendosin për ndryshime politike.

Konfederata Zvicëране

Shteti federativ zviceran ekziston që nga viti 1848. Kryeqyteti është Berni. Zvicra nuk formon unitet as etnik, as gjuhësor dhe as fetar. Meqenëse janë bashkuar vullnetarisht kultura të ndryshme, flitet për një komb vullnetar (Willensnation). Zvicra në politikën nderkombëtare është shtet neutral.

Federlizmi

Kantonet dhe komunat në Zvicër kanë autonomi të madhe, flitet për federalizëm. 26 kantonet dhe mbi 2000 komunat kanë struktura shtetërore plotësisht të zhvilluara. Kantoni Appenzell Ausserrhoden e ka kushtetutën dhe qeverinë, parlamentin dhe gjykatat e veta. Kantonet ose komunat janë përgjegjëse për një numër të madh detyrash shtetërore. Për këtë arsye, për shembull, sistemi shkollor rregullohet ndryshe nga kantoni në kanton. Ndërkaq ligjet federale zbatohen në gjithë Zvicrën, kantonet i kanë ligjet e tyre që zbatohen vetëm brenda kantonit. Për të përballuar detyrat, kantonet dhe komunat, si edhe federata, mbledhin tatime.

Ndarja e pushteteve

Për ta parandaluar koncentrimin e pushtetit, fuqia shtetëror në Zvicër dhe në kantone është ndarë në tri pushtete të pavarura: legjislativi (pushteti ligjdhënës), ekzekutivi (pushteti ligjzbatues) dhe gjyqësori (pushteti gjyqësor).

Edhe komunat e kanë legjislativin e tyre (Kuvendin Komunal ose Parlamentin) (Gemeindeversammlung, Parlament) dhe ekzekutivin (Këshillin e Qytetit apo Këshillin Bashkiak) (Stadtrat, Gemeinderat).

Në nivelin federal, legjislativi ka dy dhoma: Këshillin Kombëtar dhe Këshillin Shtetëror (National- und Ständerat). Qeveria kombëtare (7 anëtarë) quhet Bundesrat. Ekzistojnë gjithashtu gjykata të ndryshme në nivel kombëtar. Për shembull, vendimet e gjykatave kantonale mund të apelojnë në Gjykatën Supreme Federative si autoritet suprem.

Të drejtat demokratike

Zviceranet dhe zviceranët kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjedhen. Ata zgjedhin organet politike në nivel komunal, kantonal dhe federal dhe gjithashtu mund të kandidojnë vetë në zgjedhje. Përveç kësaj, qytetarët mund të mbajnë referendume për çështje politike në nivel komunal, kantonal dhe federal (demokracia e drejtpërdrejtë). Me nisma popullore, qytetarët mund të vënë në votim edhe shqetësimet e tyre. Të huajt që jetojnë në kantonin Appenzell Ausserrhoden nuk kanë të drejtë të zgjedhin apo të zgjedhen. Ata mund t'i adresojnë shqetësimet e tyre politike me peticione drejtuar autoriteteve.

Megjithatë, në Appenzell Ausserrhoden ka të drejtë vote dhe të drejta zgjedhore në nivelin komunal (komunë) për të huajt, nëse ata kanë jetuar në Zvicër për 10 vjet dhe 5 vjet në kanton. Kjo vlen për komunat Trogen, Speicher, Wald dhe Rehetobel.

Të drejtat themelore

Parimet më të larta të të drejtave në Zvicër janë të përcaktuara në Kushtetutën Federale (Bundesverfassung). Në një pjesë të rëndësishme të Kushtetutës Federale janë të drejtat themelore, të cilat bazohen në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (EMRK). Ato mbrojnë ekzistencën njerëzore (p.sh. të drejtën për jetë, të drejtën për ndihmë në raste urgjente) dhe mbrojnë individët nga dhuna shtetërore ose grupet kundër shumicës. Ato garantojnë se askush nuk do të diskriminohet për shkak të origjinës, racës, religjionit, gjinisë ose orientimit seksual. Viktimat e diskriminimit racor marrin mbështetje dhe këshilla falas në kantonin Appenzell Ausserrhoden. Liria e fesë, e mendimit dhe e shtypit mbisundon në Zvicër.

Kush është i prekur nga diskriminimi mund të kontaktojë me "HEKS Shërbimi i Këshillimit kundër Racizmit dhe Diskriminimit" (HEKS Beratungsstelle gegen Rassismus und Diskriminierung).

Për çdo pyetje në lidhje me ligjin e punës dhe ligjin për barazinë, gratë dhe burrat mund të marrin këshilla falas në Pikat e informacionit për Punë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/kantoni-appenzell-ausserrhoden/sistemi-politik